



NJOFTIM PER SHTYP

ERE dhe ZRRE intensifikojnë bashkëpunimin bilateral

Përfaqësues të Entit Rregullator për Energji (ERE) të Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës kryen një takim pune me datë 6 maj 2016, në Tiranë, për të zhvilluar dhe forcuar me tej marrëdhëniet bilaterale dhe për të përcaktuar sferat kryesore ku do të fokusojnë bashkëpunimin e tyre te metejshëm.

Kryetari i ERE-s Z. Petrit Ahmeti dhe ai i ZRRE Z. Enver Halimi, kanë vlerësuar si të domosdoshëm intensifikimin e bashkëpunimit në mes të dy rregullatorëve. Ky bashkëpunim mer një rëndësi me të madhe vecanerisht tani, kur të dy vendet po punojnë për të realizuar funksionimin e tregut të përbashkët energjetik.

Përafrimi i legjislacionit, sidomos atij sekondar; krijimi i Tregut të përbashkët të energjisë, si dhe aderimi në institucionet ndërkombëtare janë vlerësuar si prioritet i përbashkët i këtij bashkëpunimi. Këto do të arrihen përmes shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizave të dy rregullatorëve.

Ekspertët e dy Rregullatorëve kanë prezantuar para homologëve të tyre sfidat me të cilat janë duke u përballur aktualisht dhe kanë shkëmbyer mendimet profesionale në lidhje me zgjedhjet më të përshtatshme të praktikave të rregullimit ekonomik të sektorit të energjisë.

Transpozimi i legjislacionit të BE-së, ruajtja e pavarësisë, hapja dhe monitorimi i tregut janë identifikuar si sfidat kryesore me të cilat aktualisht janë duke u përballur dy rregullatorët. Për këtë është vlerësuar se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave do të ndihmojnë rregullatorët në arritjen e synimeve të përbashkëta.

Përfaqësuesit e dy Rregullatorëve kanë vendosur që takimi i ardhshëm të mbahet në Prishtinë ku dhe do të miratohet Plani i Përbashkët i Veprimit, në të cilin do të përcaktohen prioritetet dhe fushat specifike ku do të fokusohet aktiviteti i ardhshëm i Partneritetit.